



V E N D I M
Nr. 33 Datë 21.03.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË
SHOQËRISË HERA SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES
(PARKU EOLIK "PROJEKTI KAPPET") SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të nenit 9; të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" të ndryshuar, të Vendimit të Bordit të Komisionerëve Nr. 44, datë 24.07.2007 "Për miratimin e Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s," neni 18, dhe të Vendimit të Bordit të Komisionerëve Nr. 9, date 21.02.2007 "Për miratimin e Rregullave dhe Proçedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme", neni 8, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 21/03/2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria HERA shpk, për kualifikimin e impiantit prodhues (Parku Eolik "Projekti Kappet"), si burim i rinovueshëm energjie,

VENDOSI :

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "HERA" shpk për kualifikimin e impiantit prodhues (Parku Eolik "Projekti KAPPET") si burim i rinovueshëm energjie.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

Kryetari I ERE-s
Bujar Nepravishta